Republika e Kosovës

Komuna e Istogut

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË

Me nje operator ekonomik

KOMUNA E ISTOGUT-Njësija e Prokurimit, të cilën e përfaqëson menaxherja z-ja Zizë Bujupaj, Adresa Rruga "Fadil Ferati" (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;

dhe

NNP "TONI", Komuna e Drenasit, me NRB 70352095 dhe nr. Fiskal 600087169 të cilën e përfaqëson Drejtori z. Labinot Krasniqi (ne vazhdim "Kryersi I shërbimeve" , ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

"MIRËMBAJTJA E NDRIQIMIT PUBLIK NË ISTOG" LOT 2

Nr. I prokurimit	*633-19-426-2-2-1 - FA040 - Lot 2*
Nr. I brendshëm	*633 / 019 / 005 / 2-2-1*

Neni 1 ***Lënda***

1.1 ***MIRËMBAJTJA E NDRIQIMIT PUBLIK NË RRUGËT E ZONAVE URBANE NE KOMUNËN E ISTOGUT "***

Lënda e kontratës kornizë është te krijojë kushtet duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit per kryerjën e sherbimeve si ne vijim:

1,2 ***Mirëmbajtja e ndriqimit publik ne Qendrat Urbane ne teritorin e komunës së Istogut.***

1.3 Përdorimi i kesajë kontrate Publike Kornizë obligon vetem Autoritetin Kontraktues ne Istog.

1.4 kjo kontratë do te implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje kur Autoriteti Kontraktues deshiron të kryeje sherbime perkatëse.

1.5 Kryersit te sherbimeve nuk do ti lejohet modifikimi – ndryshimi i çmimit per njësi.

1.6 *Kjo kontrate Kornizë Publike do te ketë validitet (kohëzgjatje) 24. muaj, dhe është efektive nga data e nënshkrimit te njëjtës.*

1.7 *Kontrata hynë në fuqi me datë:* ***Korrik 2019*** *dhe perfundon me datë:* ***Korrik 2021***

Neni 2 Kushtet e dërgesës:

2.1 *Afati kohor për kryerje te sherbimeve do te jetë* ***2****. ditë, nga dita e dhenjes se urdhereses nga Autoriteti Kontraktues, ndersa afati i fundit kohor i përfundimit te kësajë kontrate është muaj Korrik* ***2021***

2.2 *Vendi i dorëzimit të sherbimeve do të jenë Institucionet Komunale – Drejtoratet adekuate te Autoritetit Kontraktues qendra urbane dhe rruget tjera ne teritorin e Komunës së Istogut.*

Neni 3 Çmimi

3.1 *Çmimet njësi te sherbimeve janë te paraqitura ne Ofertën Financijare, Lista e çmimit te paraqitur nga ofruesi I shërbimeve, datë:* ***07.03.2019***

3.2 *Vlera e Parashikuar e kontratës per periudhën* ***24 mujore****. është* ***40,000,00 € dhe me shkronja:*** *Katërdhjetëmijëeuro*

3.3 *Kjo kontratë mund të shkëputet edhe me heret bazuar ne Nenin 56.11 te Udhezuesit Operativ te PP po qe se e njëjta permbushet me çmim.*

3.3 *Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe / ose të Veçanta të kontratës.*

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 *Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:*

- *Kjo marrëveshje e kontratës;*
- *Kushtet e Veçanta të Kontratës;*
- *Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;*
- *Tenderi i kryersit te sherbimit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;*
- *Oferta financiare;*
- *Plani per menaxhimin e kontratës*

4.2 *Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.*

Neni 5 Komunikimet

5.1 *Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.*

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose"vendosë "do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe, në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:
Komuna e Istogut

Për Kontraktorin:
NNP "TONI"

Emri:	*Zize Bujupaj*	***Emri:***	*Labinot Krasniqi*
Pozita:	***Zyrtar Përgjegjes i Prokurimit***	***Pozita:***	***D r e j t o r***
Nënshkrimi:		***Nënshkrimi:***	
Data:		***Data:***	20.07.2019
Vula:	REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPSTINA ISTOG REPUBLIKA KOSOVO	***Vula:***	N.N.P. TONI

PJESA II E KONTRATES KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 ***"Produktet"*** përkufizohen si të mira materiale që kanë vlerë ekonomike, duke përfshirë por pa u kufizuar në mallrat, artikujt, lëndët e para, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë të lëngshme ose të gazshme.

1.3 **"Autoriteti Kontraktues"** do të thotë organizata e blerjes së mallrave, siç është e quajtur Fletën mbi të Dhënat e Tenderit.

1.4 **"Furnizues"** do të thotë një person fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon mallra që janë objekt i kësaj kontrate.

1.5 ***"Palë(t)"*** do të thotë nënshkruesit e kontratës.

1.6 **"Inkotermet"** do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë mënyrën, kostot dhe rreziqet që lidhen me transferimin e produkteve nga furnizuesi tek autoriteti kontraktues.

1.7 **"Furnizim"** do të thotë dorëzim i produkteve me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

1.8 **"Çmimi i kontratës"** do të thotë çmimi që i paguhet furnizuesit siç specifikohet në formularin e kontratës, në përputhje me shtesa të tilla dhe rregullimet ose heqjet, si mund të bëhet në bazë të kontratës.

1.9 **"Shërbimet pas shitjes"** do të thotë shërbimet ndihmëse, si: instalimi, mirëmbajtja, riparimi i furnizimeve, sigurimi i pjesëve rezervë që i prodhon apo i distribuon furnizuesi dhe/ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimet e produkteve.

1.10 **"KPK"** do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.11 **"KVK"** do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 *Transferimi*

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Furnizuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Furnizuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Furnizuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Furnizuesit siguruesve të Furnizuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Furnizuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Nr. Prokurimit: 633-19-426-2-2-1//633-019-005-221-Titulli: LOTO 1 - SINJALIZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL. LOTO 2 - MIREMBAJTJA E NDRICIMIT PUBLIK.

PJESA III E KONTRATËS kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë **Gjuha Shqipe**
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është : **Me hyrjen në fuqi të kontratës** **Kohëzgjatja e kontratës: 24 muaj pas hyrjes në fuqi të kontratës**
	6.4	Data e Përfundimit është Përfundimi : **Me implementimin e kontratës**
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është **TERRITORI I KOMUNES SE ISTOGUT**
Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues	9	• **Autoriteti Kontraktues do të përcjellë kryerjen e shërbimeve nga ofruesi i shërbimeve. Nëse ofruesi i shërbimeve nuk i përmbush kushtet e kontratës, Autoriteti Kontraktues do t'i bëjë vërejtje me shkrim.** • **Pas tri vërejtjeve (të bazuara) me shkrim ofruesit të shërbimeve do t'i ndërpritet Kontrata.**
Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve	11	Ofruesi i shërbimeve gjatë ekzekutimit të kontratës: • Ofruesi i shërbimeve gjatë ekzekutimit të kontratës është i obligueshëm t'i kryejë shërbimet në pajtim edhe me kërkesat tjera specifike të kërkuara në Specifikimin Teknik në Dosje të Tenderit. • Ofruesi i shërbimeve do të mbajë përgjegjësi ligjore dhe materiale nëse gjatë ofrimit të shërbimeve i shkakton dëm pasurisë së KOMUNES SE ISTOGUT.
Obligimet e	12.3	• **Autoriteti Kontraktues – KOMUNA E ISTOGUT do të kryejë**

Autoritetit Kontraktues		mbikëqyrjen e shërbimeve dhe do të bëjë kontrollin/inspektimin e cilësisë së shërbimeve të kërkuara. • Autoriteti Kontraktues – KOMUNA E ISTOGUT do t'i lejojë qasje të pakufizuar ofruesit të shërbimeve, për t'i përmbushur obligimet e mirëmbajtjes në pajtim me kontratën
Siguria e ekzekutimit	14.1	Vlera e sigurisë së ekzekutimit është 10 % e vlerës së kontratës, në kohëzgjatje prej 25 muaj
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	• Ofruesi i shërbimeve është përgjegjës për vegla, të gjitha materialet për mirëmbajtje, sigurim të punës, sigurim ndaj palës së tretë.
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	• Autoriteti Kontraktues do t'ia bëjë pagesat ofruesit të shërbimeve pas kryerjes së shërbimeve dhe pas konfirmimit nga Menaxheri i kontratës së AK-së se shërbimet janë kryer në pajtim me kërkesat në Dosje të Tenderit dhe në pajtim me kushtet e parapara në kontratë.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Mosmarrëveshjet do të provohen të zgjidhen në mënyrë miqësore. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë lënda do të kalojë në gjykatën kompetente siç është paraparë në pikën vijuese: 21.1.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve e cila mund të lind gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate, nëse nuk është e mundur të zgjidhet në mënyrë miqësore, lënda do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në pajtim me Ligjin në Kosovë.